

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Hartimi i projektit dhe zbatimi i punimeve për ndërtimin e godinës 11 në zonën zhvillimore “Kombinat”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45210000-2, Punime ndërtimi; 71000000-8 (Shërbime arkitektonike, inxhinierike, ndërtimi dhe inspektimi);

Vlera e fondit limit: 471,340,290.83 (katërqind e shtatëdhjetë e një milion e treqind e dyzet mijë e dyqind e nëntëdhjetë pikë tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 18 muaj kalendarikë, 2 muaj për realizimin e projekt zbatimit.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (**2023, 2024, 2025**) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. *Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “b” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: “c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenin 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

2.2.2 Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (**2023, 2024, 2025**) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet konkretisht: **471,340,290.83** (katërqind e shtatëdhjetë e një milion e treqind e dyzet mijë e dyqind e nëntëdhjetë pikë tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH. *Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 si dhe kështu për vitin 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoritetet përkatëse sipas adresave të regjistruar në QKB. *Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë*

fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;

- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim;
- Fatura tatimore përkatëse të deklaruara në organet tatimore.

1.1 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë.

1.2 Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.” AK argumenton se puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1- a,b si dhe 1.1-1.2), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: **“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.**

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: **“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.**

AK argumenton se puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1- a,b si dhe 1.1-1.2, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa më të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private lëshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nënkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nënkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nënkontraktimit lëshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qenë palë në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qenë Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të

kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyre direkte dhe as në mënyre indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik. Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kerkuar këto dokumenta në perputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: **“Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”**

2.3.2 Projektuesi i kontraktuar duhet të disponojë license projektimi sipas pikave/kategorive të mëposhtme ose të kete marreveshje bashkepunimi të noterizuar me operator ekonomik projektues të licensuar sipas legjislacionit në fuqi.

Licensa profesionale lidhur me shërbimet objekt i kontratës duhet të ketë kategoritë si më poshtë:

- 2 a) Projektim arkitekturor për objekte banimi – objekte industriale – objekte turistike;
- 2 d) Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe.
- 3 a) Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
- 4 a) Projektim të instalimeve hidro-termosantare.
- 4 c) Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.
- 4 f) Projektim të sistemeve kundër zjarrit.
- 4 h) Projektim i impianteve ngritese e transportuese (ashensor, shkallë levizese etj.)
- 4 j) Projektim të rrjeteve të telefonise, citofonise, fonise, internetit, tv, akses kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e detektimit të zjarrit etj, për objekte civile e industriale.
- 5 b) Furnizim me ujë- kolektor shkarkimi.
- 8 a) Rivetime inxhinierike.
- 9 a) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike deri 5 kate
- 12 b) Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Licensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT ose institucione të tjera të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kërkesat për licencat profesionale të projektimit bazuar në natyrën, kompleksitetin dhe disiplinat teknike të parashikuara në Detyrën e Projektimit. Nga analiza e Detyres së Projektimit rezulton se objekti përfshin projektimin e elementëve arkitektonikë, konstruktivë, hidroteknikë, elektrikë, mekanikë dhe të sistemimeve të jashtme, si dhe projektimin e sistemeve të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri, mbrojtjes atmosferike, ventilimit dhe kondicionimit, parkimit nëntokësor, ashensorëve dhe infrastrukturës ndihmëse. Mbeshtetur në vendimin Nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, “për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ku janë përcaktuar kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit në ndërtim, AK ka kërkuar licencat profesionale të projektimit 2a, 2d, 3a, 4a, 4c, 4f, 4h, 4j, 5b, 8a, 9a dhe 12b, kategori të lidhura drejtpërdrejt me disiplinat e projektimit që do të realizohen në kuadër të kontratës si me poshte:

Licencat **2a** dhe **2d** janë të nevojshme për projektimin arkitektonik dhe urbanistik të objektit; Licenca **3a** kërkohet për projektimin e strukturave dhe elementëve konstruktivë të godinës, përfshirë themelet, strukturën b/a dhe elementët mbajtës; Licencat **4a, 4c, 4f, 4h** dhe **4j** janë të domosdoshme për projektimin e instalimeve hidraulike, elektrike, sistemeve të mbrojtjes nga zjarri, sistemeve të sigurisë, mbrojtjes atmosferike, ventilimit dhe kondicionimit; Licenca **5b** lidhet me projektimin e sistemimeve të jashtme dhe infrastrukturës përkatëse; Licenca **8a** kërkohet për projektimin e elementëve dhe sistemeve të transportit vertikal (ashensorëve); Licencat **9a** dhe **12b** lidhen me disiplinat e tjera të specializuara të nevojshme për realizimin e plotë të objektit sipas kërkesave teknike të projektit. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

2.3.3 Projektuesi i kontraktuar duhet të paraqesë Licencat profesionale të stafit kryesor përgjegjës për zbatimin e shërbimit të projektimit në kategoritë si me poshte, shoqëruar me kontratë individuale pune (të vlefshme), diplome, CV, si dhe të figurojnë në Listpagesat e shoqërisë stafi si më poshtë:

PROJEKTUES ARKITEKT

Kat. 2 a) Projektim arkitekturor për objekte banimi – objekte industriale – objekte turistike;

Kat. 2 d) Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte e parqe;

PROJEKTUES KONSTRUKTOR

Kat.3 a) Objekte civile - industriale – turistike prejmurature e skelet beton arme deri në 5 kate;

PROJEKTUES INSTALATOR

Kat 4. a) Projektim të instalimeve hidro-termosanitare;

Kat. 4 c) Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale;

Kat. 4 f) Projektim të sistemeve kundër zjarrit;

Kat. 4 h) Projektim i impianteve ngritëse të transportuese (ashensor, shkallë levizëse etj.);

Kat. 4 j) Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, tv, akses kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e detektimit të zjarrit etj, për objekte civile e industriale;

PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

Kat. 5 b) Furnizim me ujë- kolektor shkarkimi;

PROJEKTUES GJEODET

Kat. 8 a) Rivelimet inxhinierike;

PROJEKTUES GJEOLIGO-INXHINIERIK

Kat. 9 a) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile - ekonomike deri 5 kate;

PROJEKTUES TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE

Kat. 12 b) Studime/vlerësime gjeologo-sizmike për trojet ku ndërtohen objektet civile, sociale e kulturore;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/c, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si pjesë të kapaciteteve profesionale stafin kryesor projektues, duke u bazuar në natyrën dhe kompleksitetin e objektit që do të projektohet dhe zbatohet. Objekti përfshin projektimin e një godine me funksione të plota ndërtimore dhe inxhinierike, duke përfshirë strukturat mbajtëse, instalimet mekanike dhe elektrike, rrjetet hidraulike, parkimin nëntokësor, sistemimet e jashtme, sistemet e mbrojtjes nga zjarri, mbrojtjes atmosferike, ventilimit dhe kondicionimit, si dhe elementë të tjerë të specializuar teknikë. Për realizimin me sukses të objektit të kontratës AK vlerëson që operatori ekonomik duhet të disponojë një grup ekspertësh të kualifikuar që mbulojnë të gjitha disiplinat e projektimit.

Referuar Detyres se Projektimit si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale është e nevojshme prezenca e **Projektuesit Arkitekt** për projektimin e zgjidhjeve arkitektonike të objektit, organizimin funksional të ambienteve, trajtimin e fasadave, materialeve të ndërtimit, aksesueshmërisë dhe integrimin e objektit me mjedisin përreth.

Referuar Detyres se Projektimit si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale është e nevojshme prezenca e **Projektues Konstruktor** për projektimin e themeleve, strukturës së betonarmuar, elementëve mbajtës dhe verifikimin e qëndrueshmërisë strukturore të objektit në përputhje me normat teknike në fuqi.

Referuar Detyres se Projektimit si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale është e nevojshme prezenca e **Projektues Instalator** për projektimin e instalimeve mekanike dhe elektrike, sistemeve të ventilimit dhe kondicionimit, instalimeve të mbrojtjes nga zjarri, sistemeve të sigurisë, ndriçimit, energjisë elektrike dhe sistemeve të emergjencës.

Referuar Detyres se Projektimit si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale është e nevojshme prezenca e **Projektues i Veprave Hidraulike** për projektimin e rrjeteve të furnizimit me ujë, shkarkimit të ujërave të zeza dhe atmosferike, si dhe zgjidhjeve të tjera hidraulike që lidhen me funksionimin e objektit dhe sistemimet e jashtme.

Referuar Detyres se Projektimit si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale është e nevojshme prezenca e **Projektues Gjeodet** për realizimin e rëqimeve topografike, përcaktimin e koordinatave, kuotave, kufijve të ndërhyrjes dhe përgatitjen e bazës topografike mbi të cilën do të mbështetet projektimi.

Referuar Detyres se Projektimit si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale është e nevojshme prezenca e **Projektues Gjeologo-Inxhinierik** për vlerësimin e kushteve gjeologjike dhe gjeoteknike të truallit, përcaktimin e karakteristikave të tokës,

rekomandimet për tipologjinë e themeleve dhe masat e nevojshme për garantimin e sigurisë së objektit.

Referuar Detyres së Projektimit si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale është e nevojshme prezenca e **Projektues i Sizmologjisë Inxhinierike** për analizimin e parametrave sizmikë të zonës së ndërtimit dhe për përcaktimin e kërkesave të projektimit antisizmik, duke garantuar që objekti të projektohet në përputhje me normat dhe standardet për rezistencën ndaj veprimeve sizmike.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkimi i këtyre specialistëve është i domosdoshëm dhe proporcional me objektin e kontratës, pasi secili prej tyre mbulon një disiplinë specifike të projektimit që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë, sigurinë, funksionalitetin dhe përputhshmërinë ligjore të projektit që do të hartohet dhe zbatohet.

2.3.4 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

- N.P – 1 A Punime gjurmimi në tokë;
- N.P – 2 D Ndertime civile dhe Industriale
- N.P – 7 A Ujesjelles, kanalizime, vepra kullimi dhe vaditje;
- N.P – 11 A Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë;
- N.P – 12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit;

PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- N.S – 1 A Punime për prishjen e ndërtesave;
- N.S – 2 A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajta e tyre;
- N.S – 3 A Impiante ngjirëse transportuese;
- N.S – 4 C Punime rifiniture të muratave dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese;
- N.S - 9 A Punime struktura speciale;
- N.S - 12 A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;
- N.S - 14 A Impiante të brendshme elektrike dhe telefonike, radiotelefoni TV;
- N.S - 18 A Punime topogjeodezike;

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislatcionit në fuqi.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ose Ministrisë kompetente të kohës, Republika e Shqipërisë, sipas Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008. Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kërkesat për licencat profesionale të zbatimit të punimeve, në përputhje me Detyrën e Projektimit, natyrën e objektit dhe praktikat të ngjashme të ndërtimi të godinave të banimit. Objekti i kontratës përfshin realizimin e një godine me funksione komplekse ndërtimore dhe teknike, duke përfshirë punime strukturore në beton të armuar, punime gjurmimi dhe themele, ndërtim të parkimit nëntokësor, fasada, sisteme të jashtme, si dhe instalime të ndryshme elektrike, mekanike, hidrosanitare, sisteme sigurie, mbrojtje nga zjarri dhe sisteme të tjera inxhinierike të integruara. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

NP-1 A Punime gjurmimi në tokë

Referuar Detyrës së Projektimit si dhe natyrës së objektit e cila përfshin punime të gjurmimit, sistemit të terrenit dhe përgatitjes së sheshit të ndërtimit, përfshirë gjurmimet për themele dhe strukturat nëntokësore si parkimi nëntokësor, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorinë *N.P-1 A*, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NP-2 D Ndërtime civile dhe Industriale

Referuar Detyrës së Projektimit si dhe natyrës së objektit e cila përfshin punime për realizimin e strukturës kryesore të godinës, përfshirë elementët mbajtës në beton të armuar, muret, kolonat, trarët dhe të gjitha punimet kryesore ndërtimore të objektit, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorinë *N.P-2 D*, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NP-7 A Ujësjetjes, kanalizime, vepra kullimi dhe vaditje

Referuar Detyrës së Projektimit si dhe natyrës së objektit e cila përfshin punime për realizimin e rrjeteve të furnizimit me ujë, shkarkimit të ujërave të zeza dhe atmosferike, si dhe sistemet e drenazhimit dhe kullimit të territorit, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorinë *N.P-7 A*, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NP-7 A Ujësjetjes, kanalizime, vepra kullimi dhe vaditje

Referuar Detyrës së Projektimit si dhe natyrës së objektit e cila përfshin punime për realizimin e rrjeteve të furnizimit me ujë, shkarkimit të ujërave të zeza dhe atmosferike, si dhe sistemet e drenazhimit dhe kullimit të territorit, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorinë *N.P-7 A*, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NP-11 A Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë

Referuar Detyrës së Projektimit si dhe natyrës së objektit e cila përfshin punime të lidhura me furnizimin energjetik të objektit dhe infrastrukturën elektrike të jashtme, përfshirë lidhjet me rrjetin

dhe strukturat teknike përkatëse, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine *N.P-11 A* , me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NP-12 A – Punime të inxhinierisë së mjedisit

Referuar Detyres së Projektimit si dhe natyrës së objektit e cila përfshin punimet që lidhen me sistemimet e jashtme, rehabilitimin e territorit, gjelbërimin, dhe ndërhyrjet që ndikojnë në përmirësimin dhe mbrojtjen e mjedisit rrethues të objektit., është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine *N.P-12 A* , me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-1 A – Punime për prishjen e ndërtesave

Referuar Detyres së Projektimit si dhe natyrës së objektit e cila përfshin punimet që lidhen me prishje, pastrime strukturore ose heqje elementësh ekzistues në zonën e ndërtimit, si pjesë e përgatitjes së kantierit, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine *N.S-1 A* , me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-2 A – Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajta e tyre

Referuar Detyres së Projektimit si dhe natyrës së objektit e cila përfshin punimet që lidhen me instalimet e furnizimit me ujë, sistemet e kanalizimeve të brendshme, pajisjet sanitare dhe infrastrukturën hidraulike të godinës, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine *N.S-2 A* , me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-3 A – Impiante ngritëse transportuese

Referuar Detyres së Projektimit si dhe natyrës së objektit e cila përfshin punimet që lidhen me instalimin e ashensorëve dhe sistemeve të transportit vertikal brenda objektit, në funksion të lëvizshmërisë dhe aksesueshmërisë së ndërtesës, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine *N.S-3 A* , me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-4 C – Punime rifiniture të muratës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese;

Referuar Detyres së Projektimit si dhe natyrës së objektit e cila përfshin punimet që lidhen me punimet e rifiniturës së brendshme dhe të jashtme, përfshirë suvatime, lysterje, veshje, fasada, materiale druri, metali dhe plastike, si dhe elementë të tjerë përfundimtarë të objektit, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine *N.S-4 C* , me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-9 A – Punime struktura speciale

Referuar Detyres së Projektimit si dhe natyrës së objektit e cila përfshin punimet që lidhen me elementë strukturalë të veçantë të objektit, përfshirë ndërhyrje teknike specifike në struktura komplekse si parkimi nëntokësor dhe elementë të veçantë inxhinierikë, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine *N.S-9 A* , me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-12 A – Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit

Referuar Detyres se Projektimit si dhe natyres se objektit e cila perfshin punimet që lidhen me sistemet HVAC, ngrohje, ventilim dhe kondicionim, të cilat janë thelbësore për funksionimin normal dhe komfortin e godinës, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine *N.S-12 A*, me qellim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-14 A – Impiante te brendshme elektrike dhe telefonike, radiotelefoni TV

Referuar Detyres se Projektimit si dhe natyres se objektit e cila perfshin punimet që lidhen me instalimet elektrike të brendshme, ndriçimin, sistemet e emergjencës, rrjetet e komunikimit, telefonisë dhe sinjalizimit në objekt, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine *N.S-14 A*, me qellim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-18 A – Punime topogjeodezike

Referuar Detyres se Projektimit si dhe natyres se objektit e cila perfshin punimet që lidhen me realizimin e rlevimeve topografike, matjeve gjeodezike dhe kontrollit të kuotave gjatë gjithë fazës së zbatimit të punimeve, duke garantuar saktësinë teknike të projektit, është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine *N.S-18 A*, me qellim përmbushjen e kontratës me sukses.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë drejtuesin teknik (inxhinier ndertimi) të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune;
- b) Kontratë pune e vlefshme;
- c) Diplomë.

Ne rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.448, datë 31.07.2025 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të punimeve të ndërtimit dhe të rregullave të kantierit”, ku në nenin 8, pika 2, përcaktohet se: “... Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”....

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e

dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimi. Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.6 Një punësim mesatar i të paktën **40 (dyzet)** personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a.** Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar.
- b.** Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Detyres së Projektimit (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Autoriteti Kontraktor argumenton se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 40 punonjësish është vendosur në përputhje me natyrën, punimet që do të realizohen, vlerën e kontratës që do të prokurohet si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm. Referuar natyrës së objektit të kontratës e cila përfshin gërmime dhe sistemime terreni, ndërtim strukture betonarme, punime murature, fasada, rifinitura të brendshme dhe të jashtme, instalime hidrosanitare, elektrike dhe mekanike, sistem HVAC, sisteme mbrojtje nga zjarri, ashensorë, si dhe sistemime të jashtme dhe punime përfundimtare, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa për një staf teknik prej minimalisht 40 punëtorësh është e

domosdoshme dhe proporcionale me objektin e kontratës. Ky staf përfaqëson minimumin e nevojshëm për të garantuar, organizimin efektiv të punës në kantier në disa fronte njëkohësisht, vijimësinë e punimeve pa ndërprerje, respektimin e standardeve teknike dhe të sigurisë në punë dhe realizimin në kohë dhe me cilësi të të gjitha zërave të punimeve të parashikuara.

Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shkëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 40 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të stafit teknik dhe projektues të nevojshme për realizimin e objektit të kontratës si dhe bazuar në kontrata të ngjashme me tipologji të njëjta me objektin e prokurimit.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

2.3.7 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili Struktura);
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (një) Inxhinier Elektrik;
- 1 (një) Inxhinier Mekanik;
- 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder;

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Detyres së Projektimit si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Detyren e Projektimit si dhe natyrën e punimeve që do të realizohen rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit inxhinierë të kërkuar sipas pikës 2.3.7, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Referuar Detyres se projektimit, kontratave te ngjashme me objektin e prokurimit si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar N.P-1, N.P-2, NS-9, NS-4 është e nevojshme prezenca e Inxhinierit të Ndërtimit (Profili Strukture).

Referuar Detyres se projektimit, kontratave te ngjashme me objektin e prokurimit si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar N.P-7, N.S-2, është e nevojshme prezenca e Inxhinierit Hidroteknik.

Referuar Detyres se projektimit, kontratave te ngjashme me objektin e prokurimit si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar N.P-11, NS-14 është e nevojshme prezenca e Inxhinierit Elektrik.

Referuar Detyres se projektimit, kontratave te ngjashme me objektin e prokurimit si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar N.S-3, NS-12 është e nevojshme prezenca e Inxhinierit Mekanik.

Referuar Detyres se projektimit, kontratave te ngjashme me objektin e prokurimit si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar, N.S-18 eshte e nevojshme prezenca e Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri.

2.3.8 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë staf (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Gjeolog;
- 1(një) punonjës i certifikuar si Specialist Për Testimin e Performancës së Materialeve/ Produkteve te Ndërtimit /Inxhinier Materialesh ose Operatori Ekonomik duhet të paraqesë raporte testimi laboratorike te leshuara nga laborator të akredituar për kryerjen e testimeve për materialet kryesore të ndërtimit (beton), sipas kërkesave të projektit.
- 1 (nje) Auditues energjetik i Certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime ne Ndertesa;
- 1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;

Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë / Çertifikatë te vlefshme, leshuar nga institucione te licensuara /akredituara nga institucionet pergjegjese shtetore, Librezë pune, CV;

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin e mësipërm, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, detyren e projektimit dhe natyrën e punimeve që do të realizohen. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Kërkesa specifike për Inxhinierët dhe punonjesit e kërkuar jo domosdoshmërisht të përfshirë në licencën e shoqërisë është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Detyres së Projektimit si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.4, kapaciteti teknik në DST, ku nevoja për prezencën e një Inxhinier Gjeolog lidhet me analizimin dhe interpretimin e kushteve gjeologjike dhe gjeoteknike që do të behen të terrenit, duke përfshirë studimin e përbërjes së tokës, kapacitetit mbajtës, nivelit të ujërave nëntokësore dhe stabilitetit të sheshit të ndërtimit; një Auditues Energjetik i Certifikuar lidhet me vlerësimin e performancës energjetike të ndërtesës dhe analizimin e eficiencës së sistemeve të projektuara (HVAC, izolim termik, ndriçim dhe konsum energjie). Përfshirja e një audituesi të certifikuar siguron përputhshmëri me standardet e eficiencës energjetike dhe kontribuon në uljen e konsumit energjetik dhe kostove operative të objektit; një Specialist Për Testimin e Performancës së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit /Inxhinier Materialeve është përgjegjës për vlerësimin dhe testimin e materialeve dhe produkteve që përdoren në industrinë e ndërtimit për t'u siguruar që ato përmbushin standardet e kërkuara për sigurinë dhe cilësinë. Ky lloj specialisti duhet të ketë njohuri të thella në lidhje me metodat e testimit, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe materialet që përdoren në ndërtim; 1 Specialist për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis lidhet me analizimin dhe vlerësimin e ndikimeve të mundshme të projektit në mjedis gjatë fazës së ndërtimit dhe funksionimit. Ky rol përfshin hartimin e masave lehtësuese për minimizimin e ndikimeve negative, duke siguruar përputhshmërinë me kërkesat ligjore për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

2.3.9 Operatori/et ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) punonjës specialist “Ekspert Zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim” në përputhje me Ligjin Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë dhënë nga Drejtoria MZSH, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave ose me marrdhënie kontraktore/kontratë (të noterizuar) me qëllim ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës “Ekspert Zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim”).

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *Ekspert Zjarrëfikës në fushën e mbrojtjes nga Zjarri dhe për shpëtim* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, ku citohet se: “Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep certifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kriterëve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit”.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Theksojmë se, referuar Detyres se Projektimit si dhe natyrës së punimeve që do të realizohen të cilat kanë potencial të shkaktimit të aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.

2.3.10 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tij personel të kualifikuar/certifikuar për 1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Autoriteti Kontraktor me vendosjen e këtij kriteri ka për qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi, në përputhje me zbatimin e rregullave në kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, sic përcaktohet në Nenin 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“. Kërkesa për disponimin e përgjegjësit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë sipas certifikimit përkatës shmang dhe parandalon çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë në kantier dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë e stafit në kantier. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri është e domosdoshme pasi shërben si garanci që ofertuesit do të realizojnë punimet në përputhje me standartet ligjore në fuqi. Funksioni i përgjegjësit për sigurinë dhe mbrojtjen në punë ka karakter parandalues dhe mbikëqyrës. Ai përfshin identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve në vendin e punës, hartimin dhe zbatimin e masave parandaluese, monitorimin e respektimit të rregullave të sigurisë, si dhe këshillimin e punëdhënësit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë

2.3.11 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" e cila të jetë e lëshuar nga shoqëria të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë

individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave"). Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

Argumentimi:

Ky kriter është hartuar në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 8, të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas të cilit: „Punëdhënsi merr masa paraprake për të organizuar dhënien e ndihmës së parë,.....“. Kërkesa për disponimin e ekspertit të ndihmës së parë dhe ndërhyrjes në emergjencë gjatë proceseve të ndërtimit në kантиer është i rëndësishëm pasi ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në dhënien e ndihmës së parë në rast aksidentesh në vendin e punës, ul rrezikun e pasojave ndaj jetës dhe shëndetit të punonjësve, në rast aksidenti, në kантиer. Në këto kushte, është kusht ligjor vendosja e këtij kriteri pasi shërben si garanci që ofertuesit do të realizojnë punimet në përputhje me standartet ligjore në fuqi

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që vërteton kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione shtetërore apo private të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë” si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. Për stafin e mëposhtëm nuk pranohen më shumë se 2 (kualifikime profesionale/teknike), si më poshtë:

- 1 (një) Teknik Ndërtimi
- 1 (një) Teknik Elektrik
- 1 (një) Teknik Mekanik
- 1 (një) Punonjës hidraulik
- 1 (një) Punonjës elektriçist
- 1 (një) Punonjës Betonues
- 1 (një) Punonjës pllakashtrues
- 1 (një) Punonjës bojaxhi
- 1 (një) Punonjës saldator
- 1 (një) Instalues dhe riparues të sistemeve ngrohje-ftohje
- 1 (një) Punonjës Hekurkthyes
- 1 (një) Punonjës Karpentier
- 1 (një) Punonjës Hidroizolues
- 1 (një) Punonjës Termoizolues
- 1 (një) Punonjës Murator/Suvatues

- 1 (një) Punonjës Punonjes per dyer dritare
 - 1 (një) Punonjës veshje fasade
 - 1 (një) Punonjës montues ashensori
- a) Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë kontratën individuale të punës te vlefshme; dhe dëshmi/certifikatë/diplomë, lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm;
 Stafi i mësipërm duhet të figurojë ne listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave
 Stafi i mësipërm duhet të jete i pajisur me certificate te sigurimit teknik, e vlefshme lëshuar nga ISHTI ose nga shoqëri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.
- b) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik pjesemarres si dhe subjektet mbeshtetes te deklaruar nga operatoret pjesemarres si subjekt mbeshtetes, duhet të deklarojnë per stafin e tyre te dhenat si me poshte:
- Per punonjesin teknik ndertimi, teknik mekanik, teknik topograf dhe teknik elektrik duhet te deklarohet emer/mbiemer, profili i punes, numer kontrate individuale të punës, diploma perkatese e shkolles se mesme si dhe institucioni qe ka leshuar dokumentin.
 - Per punonjesit e tjere te stafit teknik duhet te deklarohet emer/mbiemer, profili i punes, numer kontrate individuale të punës, numer dhe titull i kualifikimit per dëshmi /certifikatë/diplomë përkatësë, si dhe institucioni qe ka leshuar dokumentin bazuar ne Ligjin 15/2017.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Detyres se Projektimit (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me detyren e projektimit, licencat profesionale te kerkuara sipas pikes 2.3.4 duke marrë në konsideratë natyren e punimeve që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuar në Detyren e Projektimit. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik. Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga instuticione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur ne Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga instuticione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “regjistrat profesionale” të AKAFP-se. Percaktimi i numrit te punonjesve dhe profesionet eshte bazuar mbi detyren e projektimit dhe natyren e punimeve qe do te realizohen, afateve per perfundimin e punimeve, si dhe mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm

Ne lidhje me 1 (një) Teknik ndërtimi prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses, kjo kërkesë përputhet me detyren e projektimit si dhe natyren e punimeve që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

1 (një) Teknik Elektrik prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses, kjo kërkesë përputhet me detyren e projektimit si dhe natyren e punimeve që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

1 (një) Teknik Mekanik prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses, kjo kërkesë përputhet me detyren e projektimit si dhe natyren e punimeve që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

1 (një) Punonjës hidraulik prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses, kjo kërkesë përputhet me detyren e projektimit si dhe natyren e punimeve që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

1 (një) Punonjës elektrikist prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses, kjo kërkesë përputhet me detyren e projektimit si dhe natyren e punimeve që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

1 (një) Punonjës Betonues prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses, kjo kërkesë përputhet me detyren e projektimit si dhe natyren e punimeve që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

1 (një) Punonjës Pllakashtrues prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses, kjo kërkesë përputhet me detyren e projektimit si dhe natyren e punimeve që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

1 (një) Punonjës bojaxhi prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses, kjo kërkesë përputhet me detyren e projektimit si dhe natyren e punimeve që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

1 (një) Punonjës saldator prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses, kjo kërkesë përputhet me detyren e projektimit si dhe natyren e punimeve që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

1 (një) Instalues dhe riparues të sistemeve ngrohje-ftohje prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses, kjo kërkesë përputhet me detyren e projektimit si dhe natyren e punimeve që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

1 (një) Punonjës Hekurkthyes prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses, kjo kërkesë përputhet me detyren e projektimit si dhe natyren e punimeve që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

1 (një) Punonjës Karpentier prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses, kjo kërkesë përputhet me detyren e projektimit si dhe natyren e punimeve që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

1 (një) Punonjës Hidroizolues prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses, kjo kërkesë përputhet me detyren e projektimit si dhe natyren e punimeve që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

1 (një) Punonjës Termoizolues prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses, kjo kërkesë përputhet me detyren e projektimit si dhe natyren e punimeve që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

1 (një) Punonjës Murator/Suvatues prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses, kjo kërkesë përputhet me detyren e projektimit si dhe natyren e punimeve që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

1 (një) Punonjës për dritare prezencë e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses, kjo kërkesë përputhet me detyrën e projektimit si dhe natyrën e punimeve që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

1 (një) Punonjës veshje fasade prezencë e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses, kjo kërkesë përputhet me detyrën e projektimit si dhe natyrën e punimeve që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

1 (një) Punonjës montues ashensori prezencë e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses, kjo kërkesë përputhet me detyrën e projektimit si dhe natyrën e punimeve që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

2.3.13 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës si më poshtë:

- 2 (dy) Punonjës automakinist
- 1 (një) Punonjës buldozerist
- 2 (dy) Punonjës eskavatorist

Për punonjësit e mesiperm, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës të vlefshme;
 - leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.) *(Në rastin kur punonjësit eskavatorist, automakinist dhe buldozeriste janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).*
- a) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik si dhe operatorët mbështetës të deklaruar nga operatorët pjesëmarrës si subjekt mbështetës duhet të deklarojnë për punonjësit e mesiperm emrin/mbiemrin, profilin e punës, numrin e kontratës individuale të punës, numrin e dëshmive të aftësisë profesionale dhe afatin e vlefshmërisë së saj.

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në rastin kur punonjësit eskavatorist, automakinist dhe buldozeriste janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojnë emrin/mbiemrin, profilin e punës, numrin e kontratës individuale të punës, numrin e dëshmive të aftësisë profesionale dhe afatin e vlefshmërisë së saj.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

2 (dy) Automakinist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

1 (një) Buldozerist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

2 (dy) Eskavatorist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmive të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë :

- a) eskavator gjurmimi e ngarkimi dherash të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për **Eskavatorist**;

- b) buldozer gërmimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke, të gjithë llojet e traktorëve me thikë (ruspë), ose që tërheqin skreper, grejder apo nivelues, rul vibrues, shtruese asfalto-betoni, skreperët, grejderët dhe niveluesit kur janë vetëlëvizës, të gjithë llojet e traktorëve, me pajisje shtesë për ngritjen e peshave, shpimin e puseve etj., manovratorëve u jepet dëshmi për **Buldozerist**;
- c) automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti : autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak, manovratorëve u jepet dëshmi për **Automakinist**

2.3.14 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a. Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 9001:2015 ose ekuivalente.
- b. Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 14001-2015 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 14001-2015 ose ekuivalente.
- c. Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 45001-2018 ose certifikatën për standardin e përditësuar SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 45001-2023, (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 45001-2018 ose certifikatën për standardin e përditësuar SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 5001-2023 ose ekuivalente.
- d. Çertifikatën e menaxhimit të energjisë SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 50001-2018 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave elektrikë duhet të paraqesë Çertifikatën ISO ose ekuivalente.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, nëpërputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të

Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 9001:2015 ose ekuivalente, është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 9001:2015 ose ekuivalente, me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 14001:2015 ose ekuivalente, ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 14001:2015 ose ekuivalente, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 45001-2018 ose 45001-2023 ose ekuivalente, është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 45001-2018 ose ekuivalente, me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 50001-2018 ose ekuivalente, është një standard i ri i konceptuar për të asistuar kompanitë në zbatimin e një sistemi të menaxhimit të përshtatshëm për identifikimin dhe minimizimin e konsumit energjetik. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 50001:2018 ose ekuivalente, me qëllim që veprimtaria e ushtruar (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi), të reduktojë kostot energjetike të kompanive, emisionet e gazrave serë (GHG) dhe impaktet e tjera në mjedis. Në Preventivin e punimeve parashikohen zëra elektrik, ku zbatimi i tyre kërkon që Ofertuesi të jetë i pajisur me Certifikatë SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 50001-2018 ose ekuivalente. Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”*. Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat elektrike të pasrashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 12 gërma “a”- “e”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçense të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit e cila duhet të përmbajë kodin 17.09.04. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji” dhe VKM Nr.402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”.

Në raportin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis është listuar edhe “Menaxhimi i mbetjeve”. Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”. Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta: Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”. Referuar VKM nr. 402, datë 30.06.2021, ‘Për miratimin e katalogut të mbetjeve’, kodi 17 09 04 klasifikohet në grupin 17 “Mbetje nga ndërtimet dhe prishjet”. Për rrjedhojë, kërkesa që operatori ekonomik të disponojë licencën përkatëse për grumbullimin dhe transportin e këtyre mbetjeve lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe synon të garantojë që largimi i mbetjeve të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekte të autorizuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

2.3.15 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Autobetoniere	copë	2	Në pronësi ose me qera
2	Autobot uji	copë	1	Në pronësi ose me qera

3	Auto Pompë Betoni	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Fabrikë Betoni, pajisur me leje mjedisore nga QKL	copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontratë furnizimi
5	Eskavator me zinxhir	copë	2	Në pronësi ose me qera
6	Gazogjen	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Kamioncine me kapacitet deri 3.5 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
8	Kamion me kapacitet 10-20 ton	copë	3	Në pronësi ose me qera
9	Makineri për prerje hekur ndërtimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
10	Makineri për kthim hekur ndërtimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Pajisje gjeodezike Total Station	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Saldatrice elektrike/Elektrosaldatrice	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Sondë për shpime pilotash	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Vibrator thellësie	copë	2	Në pronësi ose me qera
15	Vinc kulle 6-10 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera

Pajisjet dhe mjetet nuk duhet të jenë të angazhuara në asnjë kontratë tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b. Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- c. Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).
- d. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- e. Për impiantin e betonit duhet të paraqiten kontrata e blerjes / fatura e blerjes / fatura zhdoganimit, foto të impiantit, leja mjedisore III.1.B, lëshuar nga QKL. Nëse është marrë me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë. Nëse është marrë me kontratë furnizimi, në këtë rast, duhet të paraqesë kontratën e furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton ekzistencën dhe pronësinë e impiantit, leje mjedisore kodi III.1.B, lëshuar nga QKL si dhe foto të impiantit.
- f. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qartë dhe të dallueshme për secilin mjet të deklaruar, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

- g. Për mjetet që sipas percaktimeve ligjore te qarkullimit rrugor nevojitet targa, leje qarkullimi...etj. Operatori ekonomik duhet te deklaroje në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në rubriken përkatëse të dhënat për mjetet e kërkuara në shtojcën 8.
- h. Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, afati i zbatimit te cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi.
- i. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë, me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktori.
- j. Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e zbatimit të kontratës sipas shtojcës 6.
- k. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c; dhe 6/d, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me ane 17 te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane fuqine minimale punetore, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, qe ka ne dispozicion apo qe mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten. Per te percaktuar numrin e mjeteve/makinerive te nevojshme per realizimin e kontrates, AK eshte bazuar ne Detyren e Projektimit si dhe ne kontrata me objekt prokurimi te ngjashem.

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe preventivin e punimeve i cili është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoritetit Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/UNI/EN/ISO.

Shënim:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës, sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimet e bera në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.